



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë - Ured Ministra Pravde - Office of the Minister of Justice

Nr. 209/2023  
Datë: 15 / 11 2023

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (GZ, nr. 7/01 mars 2019), nenit 11 (paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5) të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në bazë të Shtojcës 1 (pika 3) të Rregullores QRK - Nr. 14/2023 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, si dhe në pajtim me nenin 24/B (paragrafi 4) të Rregullores QRK-nr. 12/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores QRK-nr. 31/2013 për organizimin e brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë, Ministria e Drejtësisë nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Adea Geci emërohet Zyrtare në Divizionin për Koordinimin e Procesit për Mbrojtjen Juridike dhe Mbështetjen Financiare të personave të Akuzuar Potencial në Proceset Gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara.
2. E emëruara nga pika 1 e këtij Vendimi ushtron detyrat dhe përgjegjësitë e saj në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.
3. Mandati i të emëruarës në pikën 1 të këtij vendimi fillon me datë 20.11.2023 dhe zgjatë deri më datë 20.11.2025.
4. Të ardhurat personale të të emëruarës nga pika 1 e këtij vendimi do të paguhen në vlerën e caktuar me vendimin nr. 78/2021 të datës 28.04.2021.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

## Arsyetim

Me qëllim të zbatimit të obligimeve të përcaktuara me Ligjin nr. 05/L-054 për mbrojtjen juridike dhe mbështetjen financiare të personave të akuzuar potencial në proceset gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara, dhe akteve nënligjore për zbatimin e tij, me Rregulloren QRK-NR. 12/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores QRK-nr.31/2013 për Organizimin e Brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë, (tutje: Rregullorja), është themeluar Divizioni për Koordinimin e Procesit për Mbrojtjen Juridike dhe Mbështetjen Financiare të Personave të Akuzuar Potencial në Proceset Gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara (më tej: Divizioni).

Neni 24/B i Rregullores përcakton përgjegjësitë e Divizionit, numrin e të punësuarve, si dhe të drejtën e Ministrit të Drejtësisë për emërimin e zyrtarëve në këtë Divizion për periudhë të caktuar.

Duke qenë se numri i të punësuarve në Divizion nuk është i kompletuar, dhe me qëllim të kryerjes së detyrave dhe përgjegjësi të përcaktuara me legjislacionin përkatës në fuqi, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

  
Albulona HAXHIU  
Ministre e Drejtësisë

Vendim iu dërgohet:

- Znj. Adea Geci
- Kabinetit të Ministres;
- Sekretares së Përgjithshme/MD
- Divizioni për KPMJMFPAPPGJDHS
- Divizionit për Burime Njerëzore/MD
- Divizionit për Buxhet dhe Financa /MD
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.